



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr. 9 & 10

JANAR – DHJETOR 2014

BULETINI

AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. ZRRE bën rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë (Energji Elektrike, Ngrohje Qendrore dhe Gaz Natyror).

Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me Nenin 25 paragrafin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për informim të publikut lidhur me aktivitetet e saj përgatit dhe publikon Buletinin mbi aktivitetet e zhvilluara dhe pritjet për periudha afatmesme kohore. Buletinet e ZRRE-së mund të gjinden në ueb faqe të saj www.ero-ks.org.



Pamje nga trafostacioni Kosova B

Në këtë numër të Buletinit janë të paraqitura aktivitetet e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin 2014, si dhe në pika të shkurta disa aktivitete të rëndësishme që parashihen në kryhen gjatë vitit 2015. Aktivitet e kryera gjatë vitit 2014 kanë mjaftë të rëndësishme për sektorin e energjisë në Kosovë. Në vijim janë të paraqitura shkurtimisht disa nga aktivitetet e kryera nga ZRRE si:

PËRMBAJTJA

I.	Vendimet e lëshuara nga ZRRE gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2014	3
II.	Aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare, Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe Pjesëmarrja e ZRRE-së në konferenca, seminare, mbledhje ndërkombëtare, Janar – Dhjetor 2014.....	12
III.	Pjesëmarrja e ZRRE-së në takime, punëtori dhe seminare vendore	14
IV.	Aktivitetet e ZRRE-së për periudhën Janar – Dhjetor 2014	196
V.	Aktivitetet e planifikuara të ZRRE-së për periudhën Janar – Qershor 2015	17

I. Vendimet e lëshuara nga ZRRE gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2014

Kryesisht për aktivitetet e rëndësishme të ZRRE-së merret një vendim. Vendimet nxirren nga Bordi i ZRRE-së në seancë publike. Bordi i ZRRE-së përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, mirëpo gjatë vitit 2014 Bordi ka funksionuar në përbërje prej 3 anëtarësh pasi që dy anëtarëve të ZRRE-së u ka skaduar mandati, ndërsa Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të emëroj edhe dy anëtarë tjerë të bordit. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014 Bordi i ZRRE-së ka mbajtur 12 Seanca Publike ku janë nxjerrë rreth 90 vendime. Disa nga vendimet më të rëndësishme janë si më poshtë:

- Vendim V_601/1_2014 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012, për ndërmarrjen “Eurokos J.H” Sh.p.k., Dragash;
- Vendim V_606_2014 për aprovimin e “Procedura për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve” për N.Q Termokos.
- Vendim V_607_2014 për aprovimin e “Doracaku i raportimit për sektorin e energjisë”.
- Vendim V_615_2014 për aprovimin e “Rregullat e ankandit për alokimin e kapaciteteve të CAO të EJM”.
- Vendim V_616_2014 për aprovimin e amendamenteve të Kodit të Shpërndarjes.
- Vendim V_617_2014 për aprovimin e amendamenteve të Kodit të matjes së Shpërndarjes.
- Vendim V_618_2014 për Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë “KelKos Energy Peja” SH.P.K
- Vendim V_619_2014 për aprovimin e udhëzuesit për shthurje ligjore të KEDS/Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nga KEDS Furnizuesi Publik
- Vendim V_620_2014 për obligimin e kompanisë “Wind Power” SH.A që deri me 15 tetor 2014 të përfundojë instalimin e gjeneratorëve me Erë
- Vendim V_621_2014 Lidhur me APROVIMIN e METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR GJENERATORËT E RREGULLUAR
- Vendim V_621/1_2014 për aprovimin e Standardeve të sigurisë së operimit
- Vendim V_621/2_2014 për aprovimin e Standardeve të sigurisë dhe planifikimit të sistemit të transmisionit
- Vendim V_630_2014 për aprovimin e kërkesës së KEDS-it për aprovimin e faturës së gjeneruar me pajisje të dorës
- Vendim V_631_2014 për aprovimin e TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar)

- Vendim V_632_2014 për aprovimin e çmimeve të rregulluara që do të zbatohen nga operatori i licencuar i Termocentralit Kosova A dhe operatorit i licencuar Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar)
- Vendim V_632_1_2014 për lirimimin e të licencuarve nga pagesa e taksës vjetore.
- Vendim V_633_2014 për Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR)- Operatori i Sistemit të Transmisionit
- Vendim V_634_2014 për Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR)- Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes
- Vendim V_635_2014 për Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR)- Furnizuesi Publik me Energji Elektrike
- Vendim V_636_2014 për aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023”
- Vendim V_638_2014 për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar për vitin relevant tarifor SHTE8 që do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 korrik 2014.
- Vendim V_639_2014 për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin relevant tarifor apo SHTE8, i cili fillon nga 1 prill 2014.
- Vendim V_640_2014 për aprovimin e tarifave dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) Sh.A për vitin relevant tarifor apo SHTE8 që do të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2014.
- Vendim V_641_2014 për lejimin e KOSTT SH.A. derogimin në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit
- Vendim V_644_2014 për aprovimin e të hyrave maksimale të lejuara (MAR) që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të aplikohen nga Furnizuesi Publik me energji Elektrike(KEDS), për vitin rregullativ tarifor 2014
- Vendim V_645_2014 për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar për vitin relevant tarifor SHTE8
- Vendim V_652_2014 për VAZHDIMIN e licencës për gjenerim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës –Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A

- Vendim V_653_2014 për lëshimin e AUTORIZIMIT shoqërisë “Led Light Tehnology Kosova” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë nga panelet solare fotovoltaike.
- Vendim V_654_2014 për refuzimin e kërkesës për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, për njësitë: HC “Brod I” 1062 kW, HC “Brod III” (Kukalane) 3120 kW dhe HC “Restelica III” (Globoqicë) 1498 kW, në Komunën e Dragashit.
- Vendim V_655_2014 për aprovimin e amandamenteve në Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJJ
- Vendim V_660_2014 për lëshimin e AUTORIZIMIT shoqërisë “Matkos - Group” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, ZK Drekoçë, komuna e Shtërpçës
- Vendim V_661_2014 për përfundimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Lëshimin e Autorizimit V-299-2010 të datës 11 nëntor 2010 për ndërtimin e gjeneratorëve me Erë, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë.
- Vendim V_662_2014 për APROVIMIN e tarifave të ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2014/2015
- Vendim V_663_2014 për APROVIMIN e tarifave të ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2014/2015
- Vendim V_666_2014 Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë “ENERGY FIRST - ONE” SH.P.K., për zhvillimin e projektit “Wind Park–Bajgora” për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, për prodhimin e energjisë elektrike nga era, në lokacionin Selac, KK Mitrovica.
- Vendim V_667_2014 për procedurat për kyçje në rrjetin e transmisionit
- Vendim V_668_2014 për procedurat e monitorimit të përmbushjes së standardeve të kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike
- Vendim V_669_2014 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_490_2012 i datës 24 dhjetor 2012, edhe për një afat gjashtë (6) muaj, gjegjësisht deri me 24 qershor 2015.
- Vendim V_670_2014 për aprovimin e transferimit të Licencës së Furnizuesit Publik me Energji Elektrike nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. (KEDS) – Divizioni i Furnizimit, në “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” J.S.C. (KESCO).

- Vendim V_671_2014 për Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë “EKO - ENERGJI” SH.P.K., projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Morava e Binçës, HC Binça, Komuna e Vitisë.
- Vendim V_672_2014 për modifikimin e licencës për prodhim të energjisë elektrike dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH. A.), Divizioni i Gjenerimit “TC Kosova B”.
- Vendim V_673_2014 për përcaktimin e tarifave nxitëse (Feed-in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
- Vendim V_674_2014 për lejimin KOSTT SH.A. derogimin në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencës së Operatorit të Tregut
- Vendim V_675_2014 për miratimin e dokumentit Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2015-2024 për KOSTT
- Vendim V_676_2014 për aprovimin e “Planit Zhvillimor të Transmisionit 2015 – 2024” i KOSTT-it
- Vendim V_677_2014 për aprovimin e marrëveshjes për furnizim me ngrohje, e lidhur me datën 15 dhjetor 2014, në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a
- 33 vendime (vendimet 608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 622, 623, 624, 625, 626, 627, 628, 629, 642, 643, 646, 647, 648, 649, 650, 651, 656, 657, 658, 659, 664, 665, 679, 680) ankesa të konsumatorëve dhe të KEDS SH.A. (ish KEK SH.A).

II. Aktivitete të rëndësishme të Bordit të ZRRE-së - marrëveshjet dhe takimet ndërkombëtare dhe brenda vendit

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji gjatë vitit 2014 ka kryer një sërë aktivitete të rëndësishme për sektorin e energjisë. ZRRE ka zhvilluar dy procese të shqyrtimit të tarifave dhe tri të tjera për amendamentimin dhe aprovimin e rregullave sekondare. Janë mbajtur takime të shumta me palët e tjera të involuara në sektor si dhe takime të shumta me investitor potencial. Disa nga aktivitetet dhe takimet më të rëndësishme të vitit 2014 që vlen të përmenden në këtë Buletin, janë:

Takim me USAID

21 janar 2014 – anëtarët e Bordit janë takuar me përfaqësues të USAID, Scott Cameron, Drejtor i Zyrës për Rritje Ekonomike në USAID/Kosovë, Roxanne Suratgar, Këshilltare e Lartë për Energji, Arben Nagavci, Edmond Shyti si dhe dy zyrtarë të USAID nga Uashingtoni, Kristen Madler and Alan Kwan,. Qëllimi i takimit ka qenë diskutim rreth përkrahjes së ardhshme të USAID-it në sektorin e energjisë në Kosovë.

Takim me Njësinë Implementuese të Privatizimit (NJIP)

Me 23 janar 2014 – anëtarët e Bordit janë takuar me NJIP- KEDS faza e post privatizimit të mbështetur nga IFC , për një diskutim konsultues në lidhje me çështjet: Kontestet KEKsh.a.-KEDS sh.a, Balanca e energjisë 2014, Çështjet nga Shqyrtimi i shtatë të tarifave të energjisë elektrike - SHTE7 (2013-1017); Tarifat për 2014, Rregullat e tregut të energjisë, Marrëveshja teknike Kosovë-Serbi etj. Nga NJIP kanë marr pjesë Znj. Fllanza Hoxha, Menaxhere e projektit; Bernard Atlan-IFC; Filip Drapak-IFC; dhe Nick Frydas-IFC.

Dialogu teknik Kosovë- Serbi me pjesëmarrje të BE-së

Si aktivitet i rëndësishëm i ZRRE-së veçohet pjesëmarrja në punën e Grupit për Dialogun teknik për Energji, i themeluar për ta përkrahur teknikisht Dialogun në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në çështjet e energjisë. Takimet e dialogut teknik janë mbajtur në Bruksel në prezencën e përfaqësuesit të BE-së gjatë tërë vitit 2014. Në shtator të vitit 2014 si produkt i bisedimeve është nënshkruar Plan i akcional i cili në mënyrë të detajuar ka caktuar aktivitetet të secilës palë bazuar në Marrëveshjen e Energjisë të nënshkruar në vitin 2013. Në të njëjtën kohë është arritur progres edhe në aspektin e transmisionit pasi një Marrëveshje ndër OST si dhe marrëveshje operationale është nënshkruar në mes të KOSTT-it dhe EMS nga Serbia. Pas gati katër viteve të negociatave më në fund Plan i akcional dhe marrëveshjet që i rregullojnë marrëdhëniet në mes të OST-ve janë nënshkruar, gjë që paraqet një hap të madh në drejtimin të legalizimit të aktiviteteve energjetike në veri të Kosovës dhe ndërprerjen e veprimeve ilegale të operatorit serb. Operatori serb i cili ka kryer disa veprime të distribucionit në veri të Kosovës do të ndërpres punën dhe KEDS si operator ligjor i licencuar për distribucion do të zhvilloj aktivitete edhe në veri të Kosovës. Operatori serb mund të licencohet për furnizim me energjinë elektrike, por jo për distribucion të energjisë elektrike, pasi KEDS është distributor i vetëm licencuar për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Takim i Komitetit Drejtues të Projektit (KDP) "TC Kosova e Re"

31 janar 2014 – Përfaqësuesi i Bordit ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit "TC Kosova e Re".

MZHE – Prezantimi i Draft Ligjeve

7 shkurt 2014 – përfaqësues të Bordit kanë marr pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me qëllim të prezantimit të draft ligjeve të energjisë, të hartuara sipas kërkesave të pakos së tretë nga grupet punuese, në të cilat kanë marr pjesë edhe ekspert të ZRRE-së.

Takim me Përfaqësues të Komisionit Evropian për Raportin e Progresit

13 shkurt 2014 – Anëtarja e Bordit është takuar me përfaqësues të kompanisë SIGMA si e autorizuar e Komisionit Evropian për të sjell misionin e saj fakt mbledhës në Kosovë për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hartimin e Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2014. Përfaqësuesja e Bordit i ka njoftuar përfaqësuesit e kompanisë SIGMA në lidhje me zhvillimet dhe të arriturat e sektorit të energjisë nga aspekti i rregullimit ekonomik.

Takim me përfaqësues të kompanisë “Feronikeli”

18 janar 2014 – përfaqësuesi i Bordit është takuar me përfaqësues të kompanisë “Feronikeli”

Takim me Shoqatën e Ujësjellësve të Kosovës (SHUKOS)

25 shkurt 2014, përfaqësuesi i Bordit është takuar me Shoqatën e Ujësjellësve të Kosovës (SHUKOS). Për të diskutuar në lidhje me strukturën tarifore dhe kërkesën që kjo organizatë ka për ndryshimin e strukturës tarifore të energjisë elektrike sa i përket kompanive të ujësjellësve të Kosovës.

Konferenca Ndërkombëtare e KOSID mbi Opsionet e Qëndrueshme Energjetike

27 shkurt 2014 – përfaqësuesi i Bordit ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të KOSID ku temë diskutimi kanë qenë Opsionet e Qëndrueshme Energjetike

Shqyrtimi i Strukturës Tarifor

28 shkurt 2014 – në përputhje me rekomandimet e Kuvendit të Kosovës, për rishqyrtim të Strukturës Tarifore, Bordi i ZRRE ka mbajtur Seancë Publike për të diskutuar në lidhje me analizën e bërë për strukturën aktuale.

Me qëllim të përfshirjes së publikut dhe palëve të interesit, fillimisht ZRRE kishte hartuar dokumentin “Raport Konsultativ për Strukturën Tarifore”, ku janë paraqitur opsionet e mundshme lidhur me ndryshimin e strukturës ekzistuese tarifore. Pas marrjes së komenteve me shkrim nga palët e interesit por dhe gjatë mbajtjes së seancës publike, Bordi në takimin e mbajtur me 30 qershor 2014 nuk ka arritur konsensus për ndryshimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike.

Ceremoni inauguruese në KEK

5 mars 2014 – Anëtar të Bordit kanë marrë pjesë në ceremoninë inauguruese për tre projekte të cilat janë realizuar në TC Kosova A: Transporti hidraulik i hirit nga Kosova A në hapësirat e boshatisura të minierës; Instalimi i elektrofiltrit të ri në njësinë A4 dhe Komisionimi i stacionit të kompresorëve në TC Kosova A.

Takim me MZHE

5 mars 2014 – anëtar të Bordit dhe ekspert të ZRRE-së janë takuar me përfaqësues të MZHE-së për të diskutuar rreth aktiviteteve të ndërmarra nga sfera e Energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme.

Takim me FMN

27 Mars 2014 – Përfaqësuesi i Bordit të ZRRE është takuar me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar ku edhe ne pranin e akteve të tjerë të sektorit të energjisë janë diskutuar tema mbi vendosjen e tarifave në sektorin e energjisë, çështje të privatizimit dhe çështje të tjera në sektorin e energjisë në Kosovë.

Takim me përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të energjisë

24 prill 2014 – Anëtar të Bordit dhe përfaqësues të stafit të ZRRE-se janë takuar me përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të energjisë për të diskutuar mbi Progresin e arritur, aktivitetet e planifikuara dhe sfidat në rregullimin e sektorit të energjisë, Metodologjinë e Tarifave dhe çmimeve dhe konformitetin e tyre me tregun konkurrues, duke eliminuar rregullimin e çmimeve me shumicë; Detyrimet e Shërbimit publik - fushëveprimi, planet për zgjidhjet, veçanërisht në tregun me shumicë; Hapja e tregut me shumicë dhe pakicë - planet, pritjet, pengesat; Treguesit kryesorë të performancës lidhur me Raportin e zbatimit të 2013 (furnizimi, kërkesa, importit, eksporti, struktura e konsumit, infrastruktura, hapja e tregut) etj.

Takim me përfaqësues të Komisionit Evropian

22 maj 2014 – Bordi është takuar me përfaqësues të Komisionit Evropian me qëllim të evaluimit të projekteve të financuara nga BE në sektorin e energjisë (fondet IPA I).

Takim me përfaqësues të DHInfrastructure

19 qershor 2014 – përfaqësues të Bordit janë takuar me DHInfrastructure (kompani konsulence e specializuar në infrastrukturën e rrjeteve të rregulluara) e angazhuar nga IFC me qëllim të vlerësimit të projektet e partneritetit publiko-privat (PPP) të IFC-se në Evropën Jug-Lindore dhe Azinë Qendrore. Njëri prej projekteve të përzgjedhura për analizë të thellë është projekti i privatizimit të kompanisë së shpërndarjes - KEDS.

Takim me KPMG për potencialet dhe procedurat për investime në sektorin e energjisë së ripërtitshme

7 korrik 2014 – përfaqësues të Bordit dhe Departamentit Ligjor dhe Licencimit janë takuar me Karen Wordsworth - Drejtoresh e Energjisë së Ripërtitshme dhe te Qëndrueshme ne KPMG, ku është diskutuar rreth potencialeve të investimit në prodhimin e energjisë së ripërtitshme

10.9.2014 Takimi i Komitetit Drejtues të Projektit "TC Kosova e Re"

Takim me përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe USAID

30.09.2014 – Bordi i ZRRE është takuar me Z. Todd Christiansen, Zyrtar për Ekonomi pranë Ambasadës së ShBA-se ne Kosovë, z. Scott Cameron, Drejtor i Zyrës për Rritje Ekonomike pranë USAID, z. Luis Guzman, Zëvendës drejtor i po të njëjtës zyre, si dhe znj. Roxanne Suratgar, Keshilltare e Larte për Energji, për të diskutuar zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë.

Prezantim i Projektit të USAID "Repower Kosovo"

Si produkt i shumë takimeve gjatë vitit 2013 dhe 2014 në mes të ZRRE dhe Agjensionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID), USAID ka vendosur që të asistoj ZRRE-në me programin e ri pesë vjeçar të asistencës teknike për sektorin e energjisë në Kosovë "Repower Kosovo".

27 tetor 2014, Bordi dhe stafi i ZRRE-së janë takuar me përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, (USAID), dhe konsulent të kompanisë AECOM të cilët do të jenë përgjegjës për realizimin e projektit Repower Kosovo..

“Repower Kosovo” është program i financuar nga USAID për të përkrahur institucionet e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve për të siguruar energji të pastër, të sigurt dhe të përballueshme për konsumatorët. Për realizimin e këtij programi USAID ka ndarë 12 milion dollarë në mënyrë që të ndihmohen institucionet e Kosovës për të vazhduar përpjekjet për modernizimin e sektorit të energjisë elektrike në vend dhe të hapen dyert për projektet e reja të energjisë së pastër, si dhe të mundësojë krijimin e një ambienti atraktiv për investime private në sektorin e energjisë në Kosovë. Një pjesë e madhe e këtij programi përfshin asistencën për ZRRE.

Takim me përfaqësues te Komisionit Evropian "Evaluation of the EU funded Support to the Energy Sector (IPA I)"

Komiteti Drejtues i Projektit " Kosova e Re"

13 Nëntor 2014 – përfaqësuesit e Bordit të ZRRE kanë marr pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit “Kosova e Re”

Aktivitet e Partneritetit me Rregullatorin e Pensilvanisë

8 dhjetor 2014 anëtarët e Bordit janë takuar me përfaqësuesen e NARUC (Asociacionin Kombëtar të Komisioneve Rregullative të Shërbimeve) për të diskutuar në lidhje me zhvillimet e ardhshme brenda aktivitetit të Partneritetit të bashkëpunimit që ZRRE ka me Komisionin Rregullues të Pensilvanisë.

9 dhjetor 2014 ZRRE në bashkëpunim me NARUC, Komisionin Rregullativ të Pensilvanisë dhe në mbështetje të USAID ka mbajtur **Forum in e Donatorëve** – Kjo pjesë e aktivitetit është mbajtur me prezencën e donatorëve që kanë kontribuar dhe janë duke kontribuar në sektorin e energjisë. Të pranishëm ishin përfaqësues të USAID, ambasadave të Gjermanisë dhe Norvegjisë, Bankës Gjermane për Zhvillim, Bankës Botërore etj. Ky forum përveç që përmbante prezantime të rregullimit të sektorit të energjisë në Kosovë po ashtu ishte një informim më i gjerë i pjesëmarrësve me rolin e rregullatorëve amerikan sa i përket marrëdhënieve me aksionarët e tjerë në sektor, mediat dhe konsumatorët si dhe mësimet e nxjerrura nga praktikatat amerikane.



Takimi me përfaqësues të PUC dhe NARUC

10 dhjetor 2014, është mbajtur Punëtoria teknike “**Ngritja e sigurisë së furnizimit në Kosovë për sigurim të rritjes ekonomike**” e realizuar në bashkëpunim me NARUC, e mbështetur nga USAID dhe e përgatitur enkas për ZRRE dhe operatorët që e rregullohen nga ajo. Gjatë kësaj Punëtorie janë zhvilluar diskutime të disa prej çështjeve kyçe që ndërlidhen me dizajnin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, përfshirë marrëdhëniet mes akterëve të tregut, sistemet e informimit mes rregullatorëve dhe ndërmarrjeve, si dhe përkrahjen për energjinë e ripërtërishme.

Me qëllim të përmirësimit dhe përkrahjes së proceseve të privatizimit në Kosovë. Po ashtu para pjesëmarrësve, nga ekspertët e Komisionit janë prezantuar dhe diskutuar, dhe përvojat e rregullatorëve nga SHBA.

Gjithashtu përveç pjesëmarrësve së ZRRE-së, NARUC dhe PUC në këto diskutime kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë të ndërmarrjeve KEK, KEDS dhe KOSTT.

11-12 dhjetor 2014 - është mbajtur pjesa e tretë e aktivitetit të Partneritetit që ka qenë e dedikuar vetëm për stafin profesional të ZRRE-së. Në këtë takim janë diskutuar tema nga proceset e shqyrtimeve tarifore, Metodologjia e Tarifave dhe tema të tjera të aktivitetëve që janë obligim i ZRRE-së.



Takim me përfaqësues të PUC

Takim i Komitetit Drejtues

19 dhjetor 2014, përfaqësuesi i Bordit të ZRRE-së ka marrë pjesë në Komitetin Drejtues të Projektit (KDP) TC “Kosova e Re”, ku është bërë pranimi i ofertave të investitorëve të parakualifikuar për ndërtimin e TC “Kosova e RE”. Ofertën e ka dorëzuar investitori i parakualifikuar Contour Global nga shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Takim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik

22 dhjetor 2014, Bordi ka mbajtur takim me Ministrin e zhvillimit Ekonomik z. Blerand Stavileci ku janë diskutuar çështjet të ndryshme të rregullimit të sektorit të energjisë, aktivitetet me të cilat po merret ZRRE dhe sfidat që e presin këtë sektor.

III. Aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare, pjesëmarrje e stafit të ZRRE-së në konferenca, seminare, ndërkombëtare, Janar – Dhjetor 2014

Pjesëmarrja e ZRRE-së në konferenca, seminare, mbledhje të ndryshme ndërkombëtare

Edhe gjatë vitit 2014 punonjësit e ZRRE-së kanë përfaqësuar ZRRE-në me pjesëmarrje në takime të ndryshme të rëndësishme ndërkombëtare. Gjithashtu kanë kryer trajnime të ndryshme adekuate për sektor të energjisë, duke shkëmbyer përvoja me shtetet e rajonit dhe Evropës.

Në vijim janë paraqitur në pika të shkurta disa nga takimet/vizitat e realizuara në shtete të ndryshme ndërkombëtare:

4 shkurt 2014 – Pjesëmarrja në Takimin e 29-të GPG ECRB –TKE, Vjenë, Austri;

5-6 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në takimin e 31^{të} të grupit punues ECRB EWG dhe në punëtorinë për Balancim në kuadër të EnCS; Vjenë, Austri;

12 shkurt 2014 – Takimi i 27^{të} i rregullt i Grupit punues për konsumator dhe treg me pakicë, në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB-së) TKE EJM, Vjenë, Austri;

14 mars 2014 – Forumi i 2^{të} i Vjenës mbi Ligjet evropiane të energjisë, Vjenë, Austri;

22 – 23 mars 2014 – Tryezë punuese për hartimin / finalizimin e Raportit Vjetor 2013 të ZRRE-së, Durrës, Shqipëri;

25 mars 2014 – Tryeza punuese për statistika e organizuar në kuadër të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Vjenë Austri;

10-13 prill 2014 – Trajnim për menaxhimin e financave publike, Budvë, Mal i Zi;

15 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin 27^{të} të ECRB, Athinë, Greqi;

27 – 28 maj 2014 – Pjesëmarrja në Takimin e 30-të GPG ECRB –TKE, dhe Tryezën punuese për sigurinë e furnizimit, Vjenë, Austri;

02-05 qershor 2014 – Pjesëmarrje në takimin e rregullt të 32^{të} të grupit punues për energji elektrike (EWG) në kuadër të ECRB si dhe në Takimin e Forumit të Athinës, Athinë, Greqi;

10 – 11 qershor 2014 – Tryezë punuese për Burimet e ripërtërishme të energjisë organizuar nga TKE-Vjenë, Austri;

16-17 qershor 2014 – Takim i 28^{të} i rregullt i Grupit punues për konsumator dhe treg me pakicë, në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB-së) TKE EJM, Vjenë, Austri;

17 qershor 2014 – Forumi i shtatë 7^{të} social i Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;

25 shtator 2014 – Trajnim në CEER për benchmarking (studime krahasuese), Bruksel, Belgjikë;

29 shtator 2014 – Pjesëmarrje në tryezën punuese me temën “EU Energy Law & Policy Workshop”, Oslo, Norvegji;

01 tetor 2014 – Tryeza punuese e përbashkët mes CEER dhe Grupit punues për konsumator dhe treg me pakicë, në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB-së) TKE EJM, Bruksel, Belgjikë;

02 tetor 2014 – Takim i 28^{të} i rregullt i Grupit punues për konsumator dhe treg me pakicë, në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB-së) TKE EJM, Bruksel, Belgjikë;

07-08 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin e grupit punues të ECRB EWG në Vjenë dhe të workshopit për Sigurinë e furnizimit me energji; Vjenë, Austri;

7-8 tetor 2014 – Pjesëmarrja në Takimin e 30^{të} GPG ECRB –TKE dhe Forumin e 9-të të gazit, Ljubjanë, Slloveni;

08 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin e rregullt të 33^{të} të grupit punues për energji elektrike në kuadër të ECRB si, Lubjanë, Slloveni;

08 tetor 2014 – Pjesëmarrje në Forumin: Çështje Kritike dhe Zhvillimore Rregullative të Energjisë për Tregtinë Rajonale- Perspektivë nga Europa dhe Euroazia, sponsorizuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Organizuar nga Shoqata Kombëtare e Rregulloreve për ndërmarrje publike - Komisionerëve (NARUC), Stamboll, Turqi;

24 -25 tetor 2014 – Pjesëmarrje në trajnimin “Pasqyrat Financiare dhe Auditimi i Tyre”, Budvë, Mal i Zi;

05 nëntor 2014 – Takim mes delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë lidhur me implementimin e Marrëveshjes për energjinë, Bruksel, Belgjikë;

11 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në tryezën e punës “Statistikat e Energjisë” në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;

26 nëntor 2014 – Takim mes delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë lidhur me implementimin e marrëveshjes për energjinë, Vjenë, Austri.

IV. Pjesëmarrja e ZRRE-së në takime, punëtori dhe seminare vendore

Takime të shumta si me të licencuarit, poashtu edhe palët e treta janë zhvilluar si nga Bordi poashtu edhe nga punonjësit tjerë të ZRRE-së për sektorin e energjisë elektrike, energjisë termike dhe të gazit. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2014 ka pasur shumë takime me investitor të mundshëm sa i përket investimeve në energji të ripërtërishme si dhe me aplikuesit për licencat ose modifikimin e licencave ekzistuese. ZRRE po ashtu ka pasur takime pothuajse të përditshme me konsumator të ndryshëm të cilët i janë drejtuar ZRRE-së për sqarime apo edhe ankesa të ndryshme në sektor të energjisë.

Disa nga takimet e Bordit dhe të stafit të ZRRE-së janë paraqitur më poshtë:

14, 20,28,29 janar 2014 – Pjesëmarrje në takimin ZRRE për strukturën tarifore;

15 janar 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me Bordin e KEDS;

21-22 janar 2014 – Takim në MZHE: Plotësimet dhe ndryshimet e ligjeve të energjisë për të transpozuar pakon e III-të të legjislacionit Evropian për energji;

23 janar 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me përfaqësues të IFC;

23 janar 2014 – Pjesëmarrje në takimin në MZHE me përfaqësues të MZHE, KEK, KEDS, KOSTT dhe IFC lidhur me mosmarrëveshjet KEK-KEDS;

28 janar 2014 – Tryeza punuese: Studimi identifikues për projektin: Ndërrimi i lëndës djegëse NQ Gjakova, organizuar nga KfW dhe NQ Gjakova;

31 janar 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT me përfaqësues të MZHE, KEK, KEDS, KOSTT, për balancim, devijime dhe kërkesat nga Rregullat e Tregut;

13 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në telekonferencën organizuar nga TKE, për raportimin dhe adresimin e çështjeve të sigurisë së furnizimit.

13 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në telekonferencën e organizuar nga EnCS si formë për raportim për të dhënat kryesore energjetike;

13 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT për implikimet e Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim në mes TSO-ve KOSTT-EMS.

14 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në takim me KEDS-in lidhur me procedurën për shfrytëzim të paautorizuar;

21 shkurt 2014 – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e Departamentit për Konsumator në KEDS lidhur me ankesat e konsumatorëve;

25 shkurt 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me përfaqësues të SHUKOS lidhur me strukturën tarifore;

28 shkurt 2014 – Seancë Publike e ZRRE-së për Strukturën Tarifore të Energjisë Elektrike (Prishtinë, Hotel "Sirius").

03 mars 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me përfaqësues të Auditorin e Përgjithshëm lidhur me njehsorët elektrik;

6 mars 2014 – Takim në MZHE me temë nxitja e Burimeve të ripërtërishme të energjisë, komentet në UA për nxitjen e BRE-vë dhe Marrëveshjet afatgjata për shit-blerje të energjisë.

8 mars 2014 – Vizitë monitorimi të ndërtimit të hidrocentralit Deçan nga KELKOS-Energy.

10 mars 2014 – Takim në MZHE: Prezantimi i Iniciativës Energji nga Gazi nga përfaqësuesit e TKE dhe ECA (konsultanti);

12 mars 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me Bordin e KEDS-it;

01 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT lidhur me shërbimet ndihmëse të ofruara nga EMS;

02 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin me KEDS për metodologjinë e taksave të kyçje me theks të veçantë në përcaktimin e çmimeve për shërbime.

03 prill 2014 – Takim mes MZHE-Komuna Prishtinës-KEK-NQ Termokos-ZRRE-KfW për realizimin e projektit të kogjenerimit, periudhat e realizimit të kyçjes në njësitë e TC B1 dhe B2;

04 prill 2014 –Pjesëmarrje në takimin Studimi mbi mundësitë teknike dhe ekonomike të integritit të burimeve të energjisë nga era në Sistemin Transmetues të Republikës së Kosovës.

08 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me përfaqësuesit e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

10 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT lidhur me shërbimet ndihmëse të ofruara nga EMS;

15 prill 2014 – Pjesëmarrje në workshopin në MZHE në temën Parimet e rregullimit ekonomik Rishikimi i çmimeve dhe tarifave prezantuar nga Nick Frydas;

18 prill 2014 dhe 22 prill 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT lidhur me kostot për shërbimet ndihmëse të ofruara nga EMS –llogaritja sipas disa të dhënave paraprake;

22 prill 2014 – Pjesëmarrje në takim në KEDS me përfaqësuesit e KEDS-it lidhur me leximin e njehsorëve elektrik me pajisje të dorës (HHU);

29 prill 2014 – Pjesëmarrje në forumin një-ditor me të gjitha grupet relevante fetare për nevojat e tyre lidhur me çështjen energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave. Qëllimi i këtij forumi ka qenë mundësia e diskutimit të ofrimit të shërbimeve dhe diskutimi për tarifën e ujit dhe mbeturinave për objektet fetare në Kosovë;

02 maj 2014 – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;

06 – 07 maj 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me konsulentët e Mercados-it (konsulentët e BB/IFC), për për çështje të ndërlidhura me Burimet e ripërtërishme të energjisë (amendamentimin e dokumenteve Certifikata e origjinës dhe Skema Mbështetëse (FIT));

20 maj 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me KEK-un dhe KOSTT-in;

22 maj 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me përfaqësues të IPA për vlerësimin e konsulencës nga EU nga 2008 deri 2011 dhe 2011 deri 2014 (LDK);

23 maj 2014 – Pjesëmarrje në Tryezën Punuese të organizuar nga MTI mbi “Rëndësinë e verifikimit të mjeteve matëse ligjore”, kjo tryezë është mbajtur në ndertesen e MTI-së

26 maj 2014 – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e Departamentit për Konsumator në KEDS lidhur me ankesat e konsumatorëve;

06 qershor 2014 – Pjesëmarrje në takimin e mbajtur në KOSTT të grupit punues për caktimin e kostos së shërbimeve ndihmëse – rezerva terciare e ofruar nga EMS;

04 korrik 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KEK – vizitë Kosovës A për dëmet e shkaktuara nga incidenti i 6 qershorit 2014;

04 korrik 2014 – Takim mes KEK-NQ Termokos-KfW-ZRRE-MZHE: diskutim të draft marrëveshjes për furnizim me energji termike dhe komenteve të bëra nga palët;

17-18 korrik 2014 – Pjesëmarrje në takimin në MZHE – telekonferenca (ueb konferenca) me Komisionin Evropian lidhur me situatën energjetike (sigurinë e furnizimit me energji) gjatë sezonit dimëror sipas skenarëve të mundshëm të ndikimit të krizës së Ukrainës në furnizimin e gazit për Evropë ;

21 korrik 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT të grupit punues për ndikimin buxhetor dhe mënyrën e financimit të importit të energjisë elektrike si pasojë e incidentit të Kosovës A;

24 korrik 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT lidhur me furnizimin me energji në periudhën e ardhshme;

30 korrik 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KEDS për shkresën e Wind Power;

01 gusht 2014 – Pjesëmarrje në nisjen e punimeve të HC Brod në Rastelicë, Dragash;

07 gusht 2014 – Takim në MZHE për hartimin përfundimtarë të raportit për Kosovën mbi masat e Sigurisë së furnizimit me energji;

20 gusht 2014 – Takim me konsulencë BB për projektin e vlerësimit të potencialit të biomasës në Kosovë dhe përdorimit për ngrohje;

01 shtator 2014 – Takim i përbashkët KEK-NQ Termokos-KfW-ZRRE për Marrëveshjen e furnizimit me energji termike, diskutim rreth pikave diskutabile, dhe procedurës së finalizimit dhe aprovimit;

08 shtator 2014 – Pjesëmarrje në forumin një-ditor me të gjitha grupet relevante fetare për nevojat e tyre lidhur me çështjen e ujit dhe mbeturinave. Qëllimi i këtij forumi ka qenë mundësia e diskutimit të ofrimit të shërbimeve dhe diskutimi për tarifën e ujit dhe mbeturinave për objektet fetare në Kosovë;

16 shtator 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT për rishikimin e balancës së energjisë 2014;

17 shtator 2014 - vizitë në teren për inspektimin e vendit ku do të vendosen gjeneratorët e Erës me kapacitet total prej 900 kW në lokacionin “Bostan”, Novobërdë.

18-19 shtator 2014 – Pjesëmarrje në takim e organizuar nga kompania Evroenergie me temën Energy Market South East Europe 2014 –pjesëmarrje në panelin e organizuar;

18-19 shtator – Pjesëmarrje në konferencën e EVROENERGHIE: Tregu i energjisë në EJJ;

19 shtator 2014 – Pjesëmarrje në prezantimin e KfW dhe GIZ në lidhje me 15 vjetorin e bashkëpunimit Gjermano –Kosovar;

23 shtator 2014 – Pjesëmarrje në takim e organizuar nga Oda ekonomike Amerikane të tryezës mbi furnizimin me energji elektrike;

25 shtator 2014 – Pjesëmarrje në takim në KOSTT për marrëveshjen e nënshkruar Inter- TSO KOSTT-EMS; Startimi i Nominimit përmes IT së Tregut dhe Implementimi i Marrëveshjes për sigurimin e shërbimeve për LFC;

29 shtator 2014 – Pjesëmarrje në takim me KEDS rreth situatës me investime dhe probleme tjera;

30 shtator 2014 – Takim me konsulentët e projektit të BB / IFC Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ngrohjes qendrore;

02 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim në KEDS dhe vizita e bërë në teren lidhur me investimet kapitale;

13 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim në KEK lidhur me monitorimin e investimeve dhe punës në përgjithësi;

15 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim në KOSTT lidhur me Procedurat e Rregullave të Tregut

15 tetor 2014 – Trajnim në KfW prezentimi i Atlasit të Erës dhe mënyra e përdorimit dhe nxjerrjes së të dhënave;

16 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim në KOSTT i grupit punues me temë: startimi i procesit të Nominimit, Raportimi i KEK Gjenerimit lidhur me Rregullimin Primar, Implementimi i Marrëveshjes për shërbime ndihmëse me EMS;

20 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim e përbashkët NQ termokos-KEK-KfW-ZRRE për Marrëveshjen e furnizimit me energji dhe realizimin e kyçjeve në TC Kosova B.

23 tetor 2014 – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave lidhur me problemet;

27 tetor 2014 – Takim me ekspertët e USAID për projektin REpower;

28 tetor 2014 – Pjesëmarrje në workshopin e organizuar nga KfW - Wind Atlas Balkan;

29 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takim me përfaqësues të firmës Norvegjeze Statkraft për aplikim për furnizim me energji elektrike;

30 tetor 2014 – Pjesëmarrja në “Konferencën përmbyllëse e liderëve fetar”, organizuar nga OSBE në Swiss Diamond;

30 tetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KEK me përfaqësues të KEK KEDS, TERMOKOS, KFW, INTEK-ALSTOM lidhur me kogjenerimin dhe përcaktimin e periudhës shtesë për realizimin e kyçjes në njësinë B1 dhe kostove shtesë të ndërlidhura;

06 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në Termokos lidhur me ndaljen e B1 për aktivizimin e projektit të kogjenerimit;

07 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në tenderin për furnizim me energji për të mbuluar mungesën e B1 për shkak të projektit të kogjenerimit;

11 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT lidhur me kostot e Balancimit;

19 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KEDS me përfaqësuesit e KEDS-it dhe Led Light Technology;

20 nëntor 2014 – Pjesëmarrje në punëtorinë “Seminar për kapituj të zgjedhur të negociatave me BE-në në kontekst të procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit” (“Seminar on selected chapters of negotiations with the EU in the context of the Stabilization and Association Agreement process”);

05 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KEK lidhur me financimin për ndaljen e B1 për aktivizimin e projektit të kogjenerimit;

8-9 dhjetor 2014 – Pjesëmarrja në Forumin e Donatorëve organizuar nga USAID/NARUC;

09 - 12 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në Tryezën Punuese me përfaqësuesit e PUC (Pensilvania Public Utility Commission) nga SHBA të organizuar nga NARUC dhe financim nga USAID;

15 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në përfundimin e fillimit të furnizimit me ngrahje nga kogjenerimi;

16 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me KEDS për metodologjinë e taksave të kyçje me theks të veçantë në përcaktimin e çmimeve për shërbime;

18–19 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në KOSTT me temën: Kostoja e Shërbimeve Ndihmëse & Kostoja e Menaxhimit të Konxhestioneve (me Barnetin);

29 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin e KQKO të mbajtur në KOSTT;

30 dhjetor 2014 – Pjesëmarrje në takimin në ZRRE me KEK-un lidhur me disa nga zhvillimet e fundit;

Gjithashtu gjatë tërë vitit 2014 anëtarë të stafit të ZRRE-së kanë mbajtur edhe takime të ndryshme me të licencuarit dhe po ashtu me konsumatorë.

V. Aktivitetet e ZRRE-së për periudhën Janar – Dhjetor 2014

Zyra e Rregullatorit për Energji kryen funksionet dhe detyrat e saj në pajtim me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të kësaj, më poshtë janë paraqitur disa nga aktivitetet e kryera nga departamentet e ZRRE-së:

- Përgatitja e Raportit Vjetor të ZRRE-së për vitin 2013.
- Pjesëmarrje në grupin punues ndërqeveritar për hartimin (plotësimet/amendamentimet) e legjislacionit primar të energjisë dhe transpozimi i Pakos së III^{të} të legjislacionit për energjinë të Unionit Evropian këto Ligje.
- Hartimi i Udhëzuesit për shthurjen ligjore të KEDS/Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nga KEDS Furnizuesi Publik, dhe koordinimi-zbatimi i veprimeve lidhur me shthurjen.
- Transferimi i Licencës për Furnizimi Publik me energji elektrike nga KEDS në KESCO, si rezultat i shthurjes Ligjore të implementuar sipas Udhëzuesit për Shthurjen ligjore të KEDS.
- Modifikimi i Licencës së Prodhimit të energjisë elektrike në Licencë për Bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe termike, për TC Kosova B.
- Vazhdimi i Licencës për Prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova A.
- Lëshimi i dy (2) Autorizimeve finale për ndërtim të gjeneratorëve të ri: një (1) për ndërtim të HCV në Komunën e Shtërpcës, dhe një (1) për ndërtim të gjeneratorit me panele fotovoltaike në Komunën e Klinës.
- Lëshimi i tri (3) Autorizimeve Fillestare për ndërtim të gjeneratorëve të ri: dy (2) për ndërtim të HCV në Komunën e Pejës dhe Gjilanit, dhe një (1) për ndërtim të gjeneratorit me turbina ere në Komunën e Mitrovicës.
- Pranimi dhe procedimi i dhjetë (10) aplikacioneve për ndërtim të gjeneratorëve të ri të teknologjive të ndryshme.
- Pjesëmarrje në grupin punues për dekomisionimin e TC Kosova A.
- Dhjetëra e dhjetëra takime konsultative me investitor potencial për ndërtim të gjeneratorëve të ri, kryesisht nga BRE.
- Shqyrtimi i përshtatjeve të rregullta të tarifave të energjisë elektrike SHTE8, i cili ishte inicuar në vitin paraprak. Procesi i shqyrtimit të tarifave ngërthen përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që të licencuarit përkatës në shqyrtim i lejohet të mbledhë për shërbimet e ofruara ndaj konsumatorëve.
- Vlerësimi i kostove të të licencuarve dhe përmbledhja e të gjeturat në raportet e detajuara të vlerësimeve të MAR-eve të të licencuarve në kuadër të Shqyrtimit të tetë të tarifave të

energjisë elektrike SHTE8 (2014) të cilat edhe janë vërë në konsultim publik, pastaj shqyrtimi i aplikacioneve të të licencuarve është paraqitur për vendimmarrje para Bordit të ZRRE-së.

- Mbajtja e takimeve të punës ku ka pasur diskutime dhe qartësime shtesë të ofruara nga të licencuarit prej të cilave janë publikuar raportet e detajuara përfundimtare ku edhe janë propozuar të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për secilin të licencuar për periudhën pesë vjeçare dhe azhurnimet e rregullta vjetore për transmisionin dhe distribucionin, prodhimin e rregulluar dhe furnizuesin publik.
- Vendosja e Tarifave me Pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ku për këtë janë marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org si:
 - Raport Vlerësimi-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 15 maj 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të KOSTT SH.A, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Përgjigjet ndaj Komenteve të KEDS-it - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.
 - Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE), i publikuar më datën 24 Qershor 2014.
 - Raporti Konsultativ- Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8-Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifar, i publikuar më datën 13 Gusht 2014.
 - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i Tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8 - Përgjigjet në komente, i publikuar më datën 29 Gusht 2014.
- Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR), si rrjedhojë e vlerësimeve dhe raporteve të mësipërme të publikuara dhe të konsultuara nga palët e interesit, janë paraqitur para bordit propozimet për vendimmarrje për:
 - Aprovimin e Të Hyrave Maksimale Të Lejuara (MAR) dhe tarifave, që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar dhe do të aplikohen nga Furnizuesi Publik;
 - Aprovimin e Të Hyrave Maksimale Të Lejuara (MAR) dhe tarifave që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT);
 - Aprovimin e Të Hyrave Maksimale Të Lejuara (MAR) dhe tarifave që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
 - Aprovimin e Të Hyrave Maksimale Të Lejuara (MAR) dhe nagarkesave që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar).

- Shqyrtimi i jashtëzakonshëm në mënyrë që të sigurohet një funksionim stabil i sektorit të energjisë elektrike, si pasojë e shpërthimit të ndodhur në dy blloqet e TC Kosova A;
- Janë mbajtur konsultimet publike për nivelin (çmimin) e tarifave nxitëse për energjinë solare (fotovoltaike);
- Përmes Raportit Konsultativ ZRRE ka prezantuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave nxitëse dhe vlerësimet e ZRRE-së për tarifën nxitëse për energjinë solare;
- Krijimi i dokumentit për BRE-fotovoltaike si dhe plotësim ndryshimin/amendamentimin e Rregullave të ZRRE-së për BRE-të – Rregulla për Skemën mbështetëse dhe Rregulla për Certifikatën e origjinës, për Strukturën tarifore;
- Është bërë përcjellja e zhvillimeve rreth marrëveshjes së KOSTT me EMS dhe hapja e tregut – si balancimi, shërbimet ndihmëse dhe kalkulimin e shpenzimeve që mund të dalin nga këto aktivitete. Grupi Punues për vlerësimin e aplikacioneve për autorizime për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese ka vlerësuar të gjitha aplikacionet e parashtruara nga palët gjatë vitit 2014, të cilat aplikacione më pastaj kanë kaluar te Bordi për vendimmarrje.
- Komentimi dhe përgatitja për aprovim e shumë dokumenteve të KOSTT, KEK dhe KEDS si: Planet Zhvillimore, Adekuacinë, Balancën vjetore dhe afatgjate, Marrëveshjet e KOST me EMS.
- Janë bërë edhe amendamente të disa dokumenteve të të licencuarve si Metodologjia e taksave për kyçje e KOSTT, Kodet teknike, derogimet etj.;
- Shqyrtimi, komentimi dhe vlerësimi i dokumenteve dhe procedurave të hartuara nga ndërmarrjet e NQ të dorëzuara për aprovim në ZRRE, si: Procedura për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve NQ Termokos; Marrëveshja për furnizim me energji termike KEK –Termokos dhe Metodologjia e përcaktimit të energjisë termike nga kogjenerimi;
- Përcaktimi i tarifave të ngrohjes qendrore për NQ Termokos dhe NQ Gjakova, si dhe hartimi i raporteve përkatëse;
- Monitorimi i realizimit të investimeve të ndërlidhura me projektin e kogjenerimit;
- Shqyrtimi dhe dhënia e inputeve përkatëse për Studimin Identifikues të projektit Ndërimi i lëndës djegëse NQ Gjakova;
- Angazhime lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve duke bërë shqyrtimin dhe zgjidhjen e 217 ankesave të konsumatorëve, si dhe të kontesteve në mes të licencuarve. Përgjigje me shkrim të 25 ankesave të konsumatorëve duke i njoftuar dhe udhëzuar konsumatorët lidhur me ankesat e tyre, janë bërë edhe biseda direkte me palët duke i njoftuar ata me të drejtat e tyre që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.
- Analizimi dhe komentimi i dizajnit të Faturës së energjisë elektrike e cila do të gjenerohet me pajisje të dorës në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

- Hartimi i 22 përgjigjeve të ZRRE për Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur paditë e KEK-ut dhe konsumatorëve ndaj ZRRE-së si dhe angazhimi në disa seanca të gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- Plotësimi i pyetësorëve të arritur nga ECRB: për konsumatorë, treg me pakicë etj....
- Pjesëmarrja në grupin punues / komisionin për vlerësimin e aplikacioneve për autorizimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese nga BRE-të;
- Komentimi i Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë në Kosovë;
- Të gjitha departamentet e ZRRE-së gjatë vitit 2014 kanë bërë monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë në pajtim me Programin e Monitorimit të ZRRE-së, ku, pas mbledhjes së informatave të kërkuara kanë përgatitur raporte periodike mbi monitorimin.

VI. Komunikimi me media

- Stafi i ZRRE-së ka qenë vazhdimisht i përfshirë në aktivitetet që kanë të bëjnë me informimin e publikut dhe mediave.
- Përveç publikimit të materialeve dhe vendimeve të Bordit në faqen elektronike të ZRRE-së stafi profesional i ZRRE-së vazhdimisht është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve që janë dërguar përmes emailit dhe po ashtu gjatë këtij viti ka dhënë me dhjetëra intervista për radiot dhe televizionet e ndryshme në Kosovë. Po ashtu vazhdimisht janë dërguar njoftime dhe komunikata për të njoftuar mbi aktivitetet e ZRRE-së.

VII. Aktivitetet e planifikuara të ZRRE-së për periudhën Janar – Qershor 2015

Aktivitetet që ZRRE planifikon për periudhën janar - qershor 2015 janë si në vijim:

- Vlerësimi i aplikacioneve për Licencim të aktiviteteve në sektorin e energjisë.
- Vlerësimi i aplikacioneve për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Pjesëmarrja e mëtutjeshme në finalizimin e Ligjeve primare të energjisë si rezultat i obligimeve që dalin nga Pako e III^{të} e legjislacionit për energji të Unionit Evropian.
- Harmonizimi i Legjislacionit sekondar të energjisë, si rezultat i ndryshimit të Ligjeve primare të energjisë
- Analizimi, komentimi dhe vlerësimi i dokumenteve përkatëse (Kode, Rregulla, Procedura, etj) të dorëzuara nga ana e të licencuarve për aprovim nga Bordi i ZRRE-së.
- Komentimi i dokumentet e rëndësishme të KOSTT, KEK dhe KEDS si: Planet Zhvillimore, Balancën vjetore dhe afatgjate metodologjitë dhe procedurat që do të zhvillohen gjatë vitit etj.
- Shqyrtimi i ardhshëm tarifor - Përshtatjet vjetore të të hyrave dhe tarifave të Energjisë Elektrike;
- Monitorim i vazhdueshëm i ndërmarrjeve energjetike: prodhimi, transmision, shpërndarje e energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, konsumi, eksporti, importi, transiti, dhe humbjet e energjisë elektrike, po ashtu monitorimi i ndërmarrjeve energjetike në fushën e mbrojtjen së konsumatorëve si dhe për shpenzimet operative dhe kapitale.
- Mbështetje në Studimin për alokimin e kostove të shërbimeve dhe amandamentimin e legjislacionit sekondar për tarifa;
- Pjesëmarrja në grupe punuese të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në kuadër të ECRB EWG si dhe pjesëmarrje në grupe punuese të organizuar për zhvillimet në hapjen e tregut;
- Plotësim i pyetësorëve të ndryshëm që mbulojnë sferën e energjisë;
- Monitorimi i rregullt i performancës financiare dhe teknike të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, si dhe monitorimi i përmbushjes së kushteve të licencave dhe kërkesave të rregullave të nxjerra nga ZRRE;
- Kompletimi i kornizës rregulative për tarifën e ngrohjes qendrore - hartimi dhe finalizimi për aprovim: Rregullës për përcaktimin e çmimit të ngrohjes qendrore; dhe Metodologjisë së tarifave të ngrohjes qendrore;
- Shqyrtimi / përcaktimi i tarifave të ngrohjes qendrore ku përfshihen: analizimi dhe komentimi i aplikacionit tarifor, hartimi i raporteve dhe vendimeve përkatëse për përcaktimin / aprovimin e të Ardhurave të lejuara dhe tarifave;

- Shqyrtimi dhe komentimi i dokumenteve të hartuara nga të licencuarit (ndërmarrjet e NQ), si dhe finalizimi i tyre për aprovim nga Bordi i ZRRE-së;
- Përcjellja e kompletimit të projektit të kogjenerimit – realizimit të kyçjes në njësinë B2 të TC Kosova B;
- Përcjellja e zhvillimit të projektit: Ndërimi i lëndës djegëse në NQ Gjakova – Shqyrtimi dhe komentimi i Studimit të Fizibilitetit dhe dokumenteve tjera të ndërlidhura me projektin;
- Mbrojtja e konsumatorëve duke bërë shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, si dhe kontesteve në mes të licencuarve.
- Angazhimi rreth pranimin e palëve në biseda direkte lidhur me njoftimin me të drejtat e tyre për sektorin e energjisë.
- Pjesëmarrjen aktive në mekanizmat e TKE EJK për çështjet lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve – Grupi punues për konsumatorin e ECRB, dhe aktivitete tjera përkatëse; Analizimi, komentimi dhe përgatitja e dokumenteve të ndërlidhura me mbrojtjen e konsumatorëve, si pyetësorët, raportet dhe dokumentet tjera relevante.
- Përgatitja e Raportit Vjetor për vitin 2014 për sektorin e energjisë.
- Monitorimi i rregullt i ndërmarrjeve të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore – mbledhja dhe monitorimi i të dhënave dhe informatave përkatëse dhe hartimi i raporteve përkatëse të monitorimit;